REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr.2505 Prot. Vlorë, më 29/09/2026

VENDIM

Nr.17 Datë 25/09/2026

"PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË MBËSHTETJES SË PROJEKTEVE KULTURORE NË QARKUN VLORË, NË ZBATIM TË PLANIT STRATEGJIK"

Këshilli i Qarkut Vlorë, në mbledhjen e datës 25/09/2026, në mbështetje të neneve 13, 59, pika 1, shkronja "g", 110, pikat 2 dhe 4, dhe 113, pika 1, shkronja "a", dhe pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 4, pika 2, të Kartës Europiane të Autonomisë Vendore, ratifikuar me ligjin nr. 8548, datë 11.11.1999; të neneve 8, pikat 1 dhe 2; 9, pika 1, nënpikat 1.1, shkronjat "a", "b" dhe "d", 1.3, shkronja "a", dhe 1.6, shkronja "a"; 15; 18; 22, pikat 1 dhe 2; 31, pika 1; 40, pika 1; 77, shkronja "k"; 78; 79; 82, pika 1, shkronja "b"; 83, pika 1, shkronjat "c", "ç" dhe "f", dhe pika 2, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar; të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar; të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010 "Për artin dhe kulturën", të ndryshuar; të ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë"; të nenit 19, shkronja "ç", të ligjit nr. 93/2015 "Për turizmin", të ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të vendimit të Këshillit të Qarkut Vlorë nr. 25, datë 22.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Vlorë për vitin 2026 dhe PBA 2026-2028", të ndryshuar me vendimin nr. 09, datë 29.06.2026; si dhe të Planit Strategjik "Vlora 2030 – Valorizimi i thirrjeve territorial për zhvillimin ekonomik të Qarkut të Vlorës", miratuar me vendimin e Këshillit të Qarkut Vlorë nr. 8, datë 26.03.2024; duke marrë në konsideratë se Plani Strategjik është dokumenti i politikës rajonale i miratuar nga ky Këshill në ushtrim të funksionit të nenit 31, pika 1, të ligjit nr. 139/2015; sipas neneve 18 dhe 79 të ligjit nr. 139/2015,

VENDOSI:

1. Të miratojë Programin e Mbështetjes së Projekteve Kulturore në Qarkun Vlorë (në vijim "Programi"), si instrument për zbatimin e objektivave të Planit Strategjik për kulturën, trashëgiminë dhe promovimin e identitetit rajonal, sipas Aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Programi financohet vetëm brenda fondeve të miratuara në zërin "Aktivitete" të buxhetit vjetor të Këshillit të Qarkut. Projektet e thirrjes së parë financohen nga buxheti i vitit 2027. Ky vendim nuk ka efekte financiare në buxhetin e vitit 2026.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Kryetari i Këshillit të Qarkut dhe Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social, sipas detyrave që u cakton Programi.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

Anisa Hyseni
Drejtor i Drejtorisë së Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social
Mauricio Pashaj
Specialist Finance për Zbatimin e Buxhetit
Ledja Kingji
Këshilltar për qeverisjen vendore, inovacionin dhe zbatimin e projekteve në Këshillin e Qarkut Vlorë

KRYETAR

ERVIS MOÇKA
(nënshkruar dhe vulosur)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT VLORË
Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social
Sektori i Financës dhe Shërbimeve, Kordinimit të Projekteve, Politikave Sociale dhe Turizmit

ANEKSI 1

i vendimit të Këshillit të Qarkut Vlorë nr. ____, datë ____.____.2026

KËSHILLI I QARKUT VLORË

PROGRAMI I MBËSHTETJES SË PROJEKTEVE KULTURORE NË QARKUN VLORË

në zbatim të Planit Strategjik të Këshillit të Qarkut Vlorë

KREU I – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

1. Ky Program përcakton qëllimin, fushat, fondin, subjektet përfituese, procedurën e thirrjes publike, vlerësimin, financimin, monitorimin dhe raportimin e projekteve kulturore që mbështeten nga buxheti i Këshillit të Qarkut Vlorë.
2. Programi është pjesë përbërëse e vendimit të Këshillit të Qarkut Vlorë që e miraton dhe zbatohet nga administrata e Këshillit të Qarkut, nën drejtimin e Kryetarit.

Neni 2
Lidhja me Planin Strategjik

1. Programi është instrument zbatues i Planit Strategjik *"Vlora 2030 – Valorizimi I thirrjeve territorial për zhvillimin ekonomik të Qarkut të Vlorës", miratuar me Vendimin e Këshillit të Qarkut Vlorë nr. 8, datë 26.03.2024.*
2. Asnjë projekt nuk financohet nëse nuk kontribuon në mënyrë të provueshme në të paktën një objektiv ose masë të Planit Strategjik në fuqi. Objektivat e synuar shpallen në çdo thirrje.
3. Kur Plani Strategjik ndryshon, fushat dhe treguesit e këtij Programi përshtaten në thirrjen pasardhëseProgrami mbështet projekte me interes publik rajonal dhe nuk zëvendëson funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sipas nenit 25 të ligjit nr.

139/2015. Zbatohet në bashkëpunim me bashkitë e qarkut, pa qenë nevoja e ndryshimit të Programit, për aq sa nuk preken rregullat e procedurëscenuar autonominë e tyre.

Neni 3

Parimet

1. Programi zbatohet në përputhje me parimet e ligjshmërisë, barazisë dhe mosdiskriminimit, transparencës, konkurrimit të hapur, paanshmërisë, proporcionalitetit, përdorimit me ekonomi, efiçencë dhe efektivitet të fondeve publike, si dhe llogaridhënies.
2. Çdo vendimmarrje në kuadër të Programit arsyetohet me shkrim dhe dokumentohet.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë Program termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- "Thirrje" është ftesa publike për paraqitjen e projekt-propozimeve, e shpallur me urdhër të Kryetarit sipas nenit 14.
- "Viti i zbatimit" është viti buxhetor nga i cili financohen projektet e një thirrjeje.
- "Aplikant" është subjekti që paraqet një projekt-propozim brenda afatit të thirrjes.
- "Përfitues" është aplikanti, projekti i të cilit është përzgjedhur dhe me të cilin është lidhur marrëveshje financimi.
- "Projekt" është tërësia e aktiviteteve kulturore me qëllim, kalendar, preventiv dhe tregues të përcaktuar, e nisur dhe e zbatuar nga aplikanti.
- "Komisioni" është Komisioni i Vlerësimit i ngritur sipas këtij Programi.
- "Marrëveshje" është marrëveshja e financimit ndërmjet Këshillit të Qarkut dhe përfituesit.

KREU II – QËLLIMI, FUSHAT DHE TREGUESIT

Neni 5

Qëllimi dhe objektivat

1. Qëllimi i Programit është gjallërimi i jetës kulturore dhe promovimi i identitetit të Qarkut Vlorë përmes mbështetjes konkurruese të nismave të aktorëve kulturorë.
2. Objektivat specifikë janë: ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore materiale e jomateriale të qarkut; rritja e ofertës kulturore jashtë sezonit turistik dhe në zonat më pak të mbuluara; përfshirja e të rinjve në krijimtari dhe edukim kulturor; lidhja e kulturës me turizmin dhe me diasporën; bashkëpunimi kulturor ndërmjet bashkive të qarkut.

Neni 6

Linjat e mbështetjes

1. Programi mbështet projekte në këto linja:
   - Linja 1 – Trashëgimia: dokumentim, promovim dhe transmetim i folklorit, polifonisë, zejeve, veshjeve, gatimit tradicional dhe historisë lokale.
   - Linja 2 – Arte dhe krijimtari: teatër, muzikë, valle, arte pamore, film, fotografi, letërsi dhe botime me vlerë kulturore për qarkun.
   - Linja 3 – Festivale dhe panaire: ngjarje publike të traditës, me hyrje të lirë ose me çmim simbolik.
   - Linja 4 – Edukim kulturor: punëtori, kampe krijuese, konkurse dhe programe për fëmijë e të rinj.
   - Linja 5 – Promovim: projekte që promovojnë qarkun përmes kulturës, brenda vendit, në diasporë dhe në zonën ndërkufitare.
2. Thirrja mund të hapë të gjitha linjat ose vetëm disa prej tyre, sipas përparësive vjetore të Planit Strategjik dhe fondit në dispozicion.

Neni 7

Treguesit e Programit

1. Rezultatet e Programit maten çdo vit me këta tregues: numri i projekteve të financuara dhe i aplikimeve të paraqitura; numri i bashkive të mbuluara; numri i pjesëmarrësve dhe i publikut; pjesa e të rinjve nën 30 vjeç ndër pjesëmarrësit; numri i aktiviteteve të zhvilluara jashtë sezonit turistik dhe në zona rurale; vlera e bashkëfinancimit të tërhequr; përqindja e fondit të përdorur dhe e fondit të kthyer.
2. Treguesit përputhen me ata të Planit Strategjik.

KREU III – FONDI

Neni 8

Burimi dhe kufiri i fondit

1. Programi financohet vetëm nga fondi i miratuar në zërin "Aktivitete" të buxhetit vjetor të Këshillit të Qarkut. Për vitin 2026 fondi është deri në 6.000.000 lekë, sipas vendimit nr. 25, datë 22.12.2025, të ndryshuar me vendimin nr. 09, datë 29.06.2026.
2. Programi nuk krijon efekte financiare shtesë dhe nuk krijon detyrime përtej vitit buxhetortë zbatimit. Shuma e marrëveshjeve të lidhura nuk e kalon fondin e shpallur në thirrje.
3. Fondi i pashpërndarë ose i kthyer mbetet në zërin përkatës të buxhetit dhe mund të përdoret në një thirrje të dytë brenda vitit.

Neni 9

Madhësia e mbështetjes dhe bashkëfinancimi

1. Mbështetja për një projekt është jo më pak se *200.000* lekë dhe jo më shumë se *6.000.000* lekë.
2. Një aplikant paraqet jo më shumë se një projekt si aplikant kryesor dhe mund të jetë partner në jo më shumë se një projekt tjetër në të njëjtën thirrje.

3. Nuk lejohet financimi i të njëjtit shpenzim nga dy burime publike. Aplikanti deklaron të gjitha burimet e financimit të projektit.

KREU IV – PRANUESHMËRIA

Neni 10
Aplikantët e pranueshëm

1. Mund të aplikojnë: organizatat jofitimprurëse të regjistruara në gjykatë;sipas legjislacionit në fuqi, si dhe personat juridikë dhe fizikë tregtarë me objekt veprimtarie në fushën e kulturës, që kanë artin dhe kulturën në qëllimet statutore ose në objektin e veprimtarisë; individët krijues, artistët dhe studiuesit, me përvojë të provuar në fushë.
2. Aplikanti duhet të ketë selinë ose veprimtarinë në Qarkun Vlorë, ose ta zbatojë projektin në territorin e tij në partneritet me një subjekt vendas.
3. Institucionet publike dhe subjektet në varësi të tyre nuk janë aplikantë të pranueshëm, por mund të jenë partnerë pa përfituar fonde.

Neni 11
Shkaqet e përjashtimit

1. Përjashtohet aplikanti që: është në proces falimentimi ose likuidimi; ka detyrime të papaguara tatimore, të sigurimeve shoqërore ose vendore; është dënuar, ai ose përfaqësuesi i tij ligjor, me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale në fushën ekonomike, korrupsion ose mashtrim; ndodhet në konflikt interesi sipas legjislacionit në fuqi; nuk ka mbyllur raportimin ose nuk ka kthyer fondet e një financimi të mëparshëm nga Këshilli i Qarkut; ka paraqitur të dhëna ose dokumente të rreme.
2. Nuk mund të aplikojnë subjektet ku anëtarët e Këshillit të Qarkut, anëtarët e Komisionit, nëpunësit e strukturave të përfshira në Program, ose bashkëshortët, bashkëjetuesit dhe të afërmit e tyre deri në shkallën e dytë janë themelues, drejtues ose përfitues të drejtpërdrejtë nga projekti.

Neni 12

Projektet e pranueshme

1. Projekti është i pranueshëm kur: përputhet me të paktën një linjë të thirrjes dhe një objektiv të Planit Strategjik; zhvillohet në territorin e Qarkut Vlorë ose e promovon atë; është i hapur për publikun; fillon pas nënshkrimit të marrëveshjes dhe përfundon brenda afatit të thirrjes, jo më vonë se data 30 nëntor e vitit buxhetortë zbatimit; ka preventiv të detajuar dhe tregues të matshëm.
2. Nuk financohen: projekte me karakter politik, elektoral ose fetar; projekte me qëllim fitimi vetjak; projekte që nxisin urrejtje ose diskriminim; aktivitete të përfunduara; funksionimi i zakonshëm i subjektit; aktivitete që Këshilli i Qarkut i porosit vetë, për të cilat zbatohet legjislacioni i prokurimit publik.
3. Programi nuk përdoret për blerjen e mallrave, shërbimeve ose punëve për nevojat e Këshillit të Qarkut dhe as për të shmangur procedurat e prokurimit publik. Kur Këshilli i Qarkut përcakton vetë objektin dhe kushtet e një aktiviteti, zbatohet ligji nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 13
Shpenzimet

1. Janë të pranueshme shpenzimet që janë të nevojshme për projektin, të parashikuara në preventivin e miratuar, të kryera brenda periudhës së marrëveshjes, të paguara me bankë dhe të provuara me faturë tatimore ose dokument tjetër ligjor pagese.
2. Shpenzime të pranueshme janë: honorare për artistë dhe staf teknik të projektit; qira sallash, skene, fonie, ndriçimi dhe kostumesh; transport, akomodim dhe ushqim për pjesëmarrësit; materiale promovuese, botime, dokumentim foto dhe video; shpenzime të drejtpërdrejta organizative.
3. Shpenzime të papranueshme janë: pagat e stafit të përhershëm dhe shpenzimet e funksionimit të subjektit; blerja e pajisjeve dhe investimet kapitale; shpenzimet e kryera para nënshkrimit të marrëveshjes; gjobat, interesat dhe borxhet; TVSH-ja e rimbursueshme; pagesat me para në dorë; shpenzimet pa dokument justifikues.

4. Çmimet e preventivit duhet të jenë çmime tregu. Komisioni mund të ulë zërat Zërat e fryrë ose të heqë zërat e papranueshëm papranueshëm trajtohen sipas nenit 20, pika 4.

KREU V – THIRRJA DHE APLIKIMI

Neni 14
Shpallja e thirrjes

1. Thirrja shpallet me urdhër të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, me propozim të strukturës përgjegjëse dhe pas konfirmimit të fondit të lirë nga Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social. NëPër thirrjet sipas pikës 4, Drejtoria konfirmon që fondi është planifikuar për vitin e zbatimit. Për një vit zbatimi shpallen deri në dy thirrje.
2. Thirrja përmban: objektivat e Planit Strategjik që synon; linjat e hapura; fondin gjithsej dhe kufijtë për projekt; aplikantët dhe projektet e pranueshme; kriteret dhe pikët; dokumentacionin dhe formularët; mënyrën, vendin dhe afatin e dorëzimit; periudhën e zbatimit; kontaktin për sqarime; kalendarin e vlerësimit.
3. Afati i aplikimit nuk është më i shkurtër se 15 ditë kalendarike nga publikimi. Thirrja publikohet në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale të Këshillit të Qarkut, afishohet në këndin e njoftimeve dhe u dërgohet bashkive të qarkut për afishim.
4. Thirrja mund të shpallet dhe projektet mund të vlerësohen në vitin që paraprin vitin e zbatimit. Në këtë rast, thirrja shpall se financimi varet nga miratimi i fondit në buxhetin e vitit të zbatimit, marrëveshjet lidhen vetëm pas hyrjes në fuqi të atij buxheti dhe, kur fondi i miratuar është më i vogël se ai i shpallur, projektet financohen sipas renditjes deri në shterimin e tij. Renditja nuk krijon detyrim financiar për Këshillin e Qarkut para lidhjes së marrëveshjes.

Neni 15
Sqarimet dhe seanca informuese

1. Pyetjet paraqiten me shkrim jo më vonë se 5 ditë para mbylljes së afatit. Përgjigjet publikohen për të gjithë, pa identifikuar pyetësin, jo më vonë se 3 ditë para mbylljes.
2. Struktura përgjegjëse organizon të paktën një seancë informuese të hapur gjatë afatit të thirrjes. Nëpunësit nuk ndihmojnë në hartimin e asnjë aplikimi.

Neni 16
Dokumentacioni dhe dorëzimi

1. Aplikimi përmban: kërkesën dhe formularin e aplikimit; përshkrimin e projektit; preventivin për Këshillin e Qarkut dhe preventivin e përgjithshëm; për subjektet e regjistruara, dokumentet e regjistrimit të subjektit ose dokumentin e identifikimit dhe CV-në për individët;dhe vërtetimet e statusit aktiv dhe të mungesës së detyrimeve; për individët, dokumentin e identifikimit, CV-në dhe dokumentet që provojnë përvojën në fushë; IBAN në lekë; vetëdeklarimet për gjendjen gjyqësore, konfliktin e interesit, financimin e dyfishtë dhe të drejtën e autorit; marrëveshjet e partneritetit dhe përvojat e ngjashme, kur ka.
2. Aplikimi dorëzohet në protokollin e Këshillit të Qarkut, në zarf të mbyllur me shënimin e thirrjes, ose në adresën elektronike të shpallur. Protokolli shënon datën dhe orën. Aplikimet e mbërritura pas afatit nuk hapen dhe i kthehen aplikantit.
3. Aplikimi nuk mund të ndryshohet pas mbylljes së afatit, me përjashtim të plotësimeve formale sipas nenit për fazën e parë të vlerësimit19, pika 2.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT VLORË
Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social
Sektori i Financës dhe Shërbimeve, Kordinimit të Projekteve, Politikave Sociale dhe Turizmit

KREU VI – VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA

Neni 17
Komisioni i Vlerësimit

1. Komisioni ngrihet me urdhër të Kryetarit për çdo thirrje dhe përbëhet nga 5 anëtarë me të drejtë vote: tre nëpunës të administratës së Këshillit të Qarkut, ndër të cilët një nga struktura e financës dhe një jurist, dhe dy ekspertë të jashtëm me përvojë jo më pak se 5 vjet në fushën e kulturës. Urdhri cakton kryetarin, dy anëtarë zëvendësues dhe sekretarin teknik pa të drejtë vote. Përbërja e Komisionit respekton legjislacionin për barazinë gjinore.
2. Anëtarët e Këshillit të Qarkut, Kryetari dhe Zëvendëskryetari nuk janë anëtarë të Komisionit. Nëpunësi që nënshkruan ose ekzekuton pagesat nuk është anëtar me të drejtë vote.
3. Pjesëmarrja në Komision është pa shpërblim. Komisioni mblidhet kur janë të pranishëm të paktën 4 anëtarë dhe vendos me shumicën e të pranishmëve. Në rast barazie votash, vendimtare është vota e kryetarit të Komisionit.

Neni 18
Paanshmëria dhe konfidencialiteti

1. ParaPasi njihen me listën e aplikantëve dhe para hapjes së aplikimeve, çdo anëtar dhe sekretari nënshkruajnë deklaratën e mungesës së konfliktit të interesit dhe të konfidencialitetit, pasi njihen me listën e aplikantëve.
2. Anëtari që ndodhet në kushtet e nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative ose të ligjit nr. 9367/2005 tërhiqet menjëherë dhe zëvendësohet. Mosdeklarimi e bën të pavlefshëm vlerësimin e tij dhe, për nëpunësit, përbën shkak për përgjegjësi disiplinore.
3. Gjatë vlerësimit ndalohet çdo komunikim me aplikantët për përmbajtjen e vlerësimit. Çdo përpjekje ndikimi shënohet në procesverbal dhe mund të sjellë skualifikimin e aplikimit.

Neni 19
Faza e parë – verifikimi administrativ

1. Komisioni hap aplikimet në mbledhje, regjistron aplikantët dhe verifikon: dorëzimin brenda afatit; plotësinë e dokumentacionit; pranueshmërinë e aplikantit dhe të projektit; respektimin e kufijve të mbështetjes.
2. Për mangësi formale që nuk prekin përmbajtjen e projektit ose preventivin, aplikantit i jepet një afat prej 3 ditësh pune për plotësim. E njëjta mundësi u jepet të gjithë aplikantëve në të njëjtat kushte.
3. Aplikimet që nuk kalojnë fazën e parë nuk vlerësohen më tej. Aplikanti njoftohet me shkrim, me arsyet përkatëse.

Neni 20
Faza e dytë – vlerësimi teknik

1. Çdo anëtar vlerëson individualisht çdo projekt në fletën e vlerësimit, sipas kritereve të Shtojcës 1, dhe arsyeton shkurt pikët për çdo kriter. Pikët përfundimtare janë mesatarja aritmetike e pikëve të anëtarëve.
2. Kur pikët e dy anëtarëve për të njëjtin projekt ndryshojnë me më shumë se 25 pikë, Komisioni e diskuton projektin dhe anëtarët mund t'i rishikojnë pikët me arsyetim të shënuar në procesverbal.
3. Projektet renditen sipas pikëve. Financohen, sipas renditjes dhe deri në shterimin e fondit, projektet me jo më pak se 60 pikë. Në rast pikësh të barabarta, përparësi ka projekti me më shumë pikë në kriterin e lidhjes me Planin Strategjik, pastaj në kriterin e ndikimit rajonal.
4. Komisioni mund të propozojë financim të pjesshëm kur heq zëra të papranueshëm ose të fryrë, me kusht që projekti të mbetet i realizueshëm dhe aplikanti ta pranojë me shkrim preventivin e rishikuar brenda 3 ditëve pune.
5. Projektet mbime jo më pak se 60 pikë që mbeten pa fond formojnë listën rezervë, e vlefshme deri në fund të vitit buxhetortë zbatimit, për rastet e tërheqjes së një përfituesi ose të kthimit të fondeve.

6. Komisioni harton procesverbalin përfundimtar me listën e renditjes, pikët, shumat e propozuara dhe arsyet e përjashtimeve, të nënshkruar nga të gjithë anëtarët. Anëtari me mendim ndryshe e shënon atë me shkrim.

Neni 21

Miratimi, publikimi dhe vërejtjet

1. Kryetari miraton me urdhër listën e renditjes brenda 5 ditëve pune nga dorëzimi i procesverbalit. Kryetari nuk ndryshon renditjen dhe pikët; kur vëren shkelje të procedurës, ia kthen materialin Komisionit një herë, me arsyetim me shkrim.
2. Lista me emrin e aplikantit, titullin e projektit, pikët dhe shumën publikohet në faqen zyrtare brenda 5 ditëve pune nga miratimi. Çdo aplikant ka të drejtë të njihet me fletët e vlerësimit të projektit të vet.
3. Aplikanti mund të paraqesë vërejtje me shkrim brenda 5 ditëve pune nga publikimi. Kryetari vendos brenda 5 ditëve pune, pas mendimit me shkrim të një nëpunësi jurist që nuk ka marrë pjesë në vlerësim. Marrëveshjet nënshkruhen pas përfundimit të këtij afati.
4. Ky nen nuk cenon të drejtën e ankimit administrativ dhe gjyqësor sipas Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit për gjykatat administrative.

KREU VII – MARRËVESHJA DHE PAGESAT

Neni 22

Marrëveshja e financimit

1. Me çdo përfitues lidhet marrëveshje brenda 10 ditëve pune nga mbyllja evendimi për vërejtjet ose, kur nuk ka vërejtje, nga mbarimi i afatit të vërejtjevetyre; për thirrjet sipas nenit 14, pika 4, afati fillon nga hyrja në fuqi e buxhetit të vitit të zbatimit, kur ajo vjen më vonë. Përfituesi që nuk paraqitet për nënshkrim pa shkak të arsyeshëm zëvendësohet nga lista rezervë.
2. Marrëveshja përmban: palët; objektin dhe periudhën e zbatimit; shumën dhe preventivin e miratuar si aneks; kalendarin e aktiviteteve dhe treguesit; mënyrën e pagesës; detyrimet e dukshmërisë; raportimin; të drejtën e Këshillit të Qarkut për monitorim dhe

kontroll; rastet e pezullimit, zgjidhjes dhe kthimit të fondeve; ruajtjen e dokumenteve për jo më pak se 5 vjet; zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

3. Para nënshkrimit, përfituesi paraqet origjinalet ose kopjet e njësuara të vërtetimeve të deklaruara në aplikim.

Neni 23

Pagesat

1. Pagesat kryhen vetëm me bankë, në llogarinë e përfituesit, përmes sistemit të Thesarit, brenda limitit të zërit buxhetor.
2. Pagesa bëhet me dy këste: deri në 50 për qind pas nënshkrimit të marrëveshjes dhe pjesa tjetër pas miratimit të raportit përfundimtar.
3. Për individët dhe subjektet e tjera, kur e kërkon legjislacioni tatimor, Këshilli i Qarkut mban tatimin në burim. Përfituesi mban përgjegjësi për detyrimet e veta tatimore dhe të sigurimeve.

Neni 24

Ndryshimet gjatë zbatimit

1. Zhvendosjet ndërmjet zërave të preventivit deri në 10 për qind të zërit bëhen me njoftim me shkrim. Ndryshimet më të mëdha, ndryshimi i datave, i vendit ose i aktiviteteve kërkojnë miratim paraprak me shkrim nga struktura përgjegjëse dhe, kur prekin thelbin e projektit, shtojcë të marrëveshjes.
2. Asnjë ndryshim nuk e rrit shumën e mbështetjes dhe nuk e zgjat zbatimin përtej datës 30 nëntor.

Neni 25

Dukshmëria

1. Përfituesi vendos në çdo material, njoftim dhe aktivitet stemën e Këshillit të Qarkut Vlorë dhe shënimin "Projekt i mbështetur nga Këshilli i Qarkut Vlorë". Struktura përgjegjëse njoftohet të paktën 5 ditë para çdo aktiviteti publik.

2. Këshilli i Qarkut ka të drejtë të përdorë pa pagesë, për qëllime promovimi jotregtar, fotot, videot dhe materialet e prodhuara nga projekti, duke respektuar të drejtat morale të autorit.

KREU VIII – MONITORIMI, RAPORTIMI DHE KTHIMI I FONDEVE

Neni 26
Monitorimi

1. Struktura përgjegjëse cakton për çdo projekt një nëpunës monitorues, i cili nuk ka qenë anëtar i Komisionit. Monitoruesi kryen të paktën një verifikim në vend gjatë aktivitetit kryesor dhe harton procesverbal me foto.
2. Kur konstatohen shmangie, përfituesit i jepet afat me shkrim për korrigjim. Shmangiet e rënda i raportohen menjëherë Kryetarit.

Neni 27
Raportimi i përfituesit

1. Përfituesi dorëzon brenda 30 ditëve nga përfundimi i projektit, dhe jo më vonë se data 15 dhjetor, raportin narrativ me treguesit e arritur, foto, video dhe materiale, si dhe raportin financiar me pasqyrën e shpenzimeve sipas preventivit, faturat tatimore, kontratat, listëpagesat dhe urdhërpagesat bankare.
2. Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social verifikon raportin financiar brenda 10 ditëve pune. Njihen vetëm shpenzimet e pranueshme dhe të provuara. Kësti i fundit llogaritet mbi shpenzimet e njohura.

Neni 28
Kthimi i fondeve dhe masat

1. Përfituesi kthen brenda 15 ditëve nga njoftimi: fondet e papërdorura; shumat për shpenzime të panjohura; të gjithë shumën, kur projekti nuk është zbatuar, janë paraqitur dokumente të rreme ose ka pasur financim të dyfishtë.

2. Kur shuma nuk kthehet vullnetarisht, Këshilli i Qarkut ndjek rrugën gjyqësore. Kur ka dyshime për vepër penale, bëhet kallëzim në organin kompetent.
3. Përfituesi që nuk raporton, nuk kthen fondet ose ka paraqitur të dhëna të rreme përjashtohet nga thirrjet për 3 vitet pasardhëse.

KREU IX – TRANSPARENCA, TË DHËNAT DHE LLOGARIDHËNIA

Neni 29
Regjistri publik dhe e drejta e informimit

1. Këshilli i Qarkut mban dhe publikon në faqen zyrtare regjistrin e Programit, me thirrjet, aplikantët, pikët, përfituesit, shumat e miratuara dhe të paguara, si dhe gjendjen e raportimit.
2. Dokumentet e Programit jepen sipas ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", me kufizimet që ai parashikon.

Neni 30
Të dhënat personale dhe arkivimi

1. Të dhënat personale të aplikantëve përpunohen vetëm për qëllimet e Programit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Aplikanti njoftohet në formular për publikimin e emrit, projektit, pikëve dhe shumës.
2. Dosja e çdo thirrjeje dhe e çdo projekti ruhet e plotë, si gjurmë auditimi sipas ligjit nr. 10296/2010, dhe arkivohet sipas legjislacionit për arkivat.

Neni 31
Raportimi në Këshill dhe rishikimi

1. Kryetari i paraqet Këshillit të Qarkut, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, raportin vjetor të Programit me treguesit e arritur, kontributin në Planin Strategjik, fondin e përdorur e të kthyer, vërejtjet e paraqitura dhe mësimet e nxjerra.
2. Programi rishikohet nga Këshilli i Qarkut pas thirrjes së parë dhe më pas sa herë ndryshon Plani Strategjik ose e kërkon praktika e zbatimit.

KREU X – DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 32
Thirrja e parë

Për vitin 2026 shpallet një thirrje e vetme. Kur koha e mbetur deri në fund të vitit buxhetor nuk lejon zbatimin dhe raportimin e rregullt të projekteve, thirrjaThirrja e parë shpallet në tremujorin e parë të vitit dhe vlerësohet në vitin 2026, sipas nenit 14, pika 4, dhe projektet e saj zbatohen në vitin 2027, brenda fondit të buxhetit të atij viti.

Neni 33
Formularët dhe shtojcat

1. Kryetari miraton me urdhër, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit, formularët standardë: formularin e aplikimit; dy formatet e preventivit; vetëdeklarimet; deklaratën e konfliktit të interesit dhe të konfidencialitetit; fletën e vlerësimit; modelin e procesverbalit; modelin e marrëveshjes; formatin e raportit narrativ dhe financiar; procesverbalin e monitorimit. Formularët zbatojnë këtë Program dhe nuk shtojnë kushte, kritere ose detyrime të reja.
2. Shtojca 1 "Kriteret dhe shkalla e vlerësimit" dhe Shtojca 2 "Kalendari tip i një thirrjeje" janë pjesë përbërëse e këtij Programi.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT VLORË

Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social
Sektori i Financës dhe Shërbimeve, Kordinimit të Projekteve,
Politikave Sociale dhe Turizmit

SHTOJCA 1

KRITERET DHE SHKALLA E VLERËSIMIT

Nr.	Kriteri dhe çfarë vlerësohet	Pikë
1	Lidhja me Planin Strategjik: objektivi i synuar është i qartë; aktivitetet kontribuojnë drejtpërdrejt në të; treguesit e projektit lidhen me treguesit e Planit	20
2	Cilësia kulturore dhe artistike: vlera e përmbajtjes, origjinaliteti, cilësia e artistëve dhe ekspertëve të përfshirë, respektimi i autenticitetit të trashëgimisë	20
3	Ndikimi rajonal: shtrirja në më shumë se një bashki; numri i pjesëmarrësve dhe publikut; përfshirja e të rinjve, zonave rurale dhe grupeve më pak të përfaqësuara; zhvillimi jashtë sezonit	20
4	Realizueshmëria: plan pune dhe kalendar realist; përvoja dhe kapaciteti i aplikantit; partneritetet; menaxhimi i rreziqeve	15
5	Buxheti: çmime tregu; preventiv i detajuar dhe i lidhur me aktivitetet; raport i mirë kosto–përfitim; pjesë e ulët e shpenzimeve administrative	15
6	Bashkëfinancimi dhe qëndrueshmëria: masa e bashkëfinancimit mbi minimumin; vazhdimësia e projektit pas mbështetjes; dukshmëria dhe promovimi i qarkut	10
	Gjithsej (pragu i financimit: 60 pikë)	100

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT VLORË

Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social
Sektori i Financës dhe Shërbimeve, Kordinimit të Projekteve, Politikave Sociale dhe Turizmit

Shkalla e pikëzimit për çdo kriter

Niveli	Përshkrimi	Pjesa e pikëve të kriterit
Shumë mirë	Kriteri plotësohet tërësisht, me prova bindëse	81–100 %
Mirë	Plotësohet në pjesën më të madhe, me mangësi të vogla	61–80 %
Mjaftueshëm	Plotësohet pjesërisht, me mangësi të dukshme	41–60 %
Dobët	Plotësohet pak ose pa prova	1–40 %
Aspak	Nuk plotësohet ose mungon informacioni	0 %

Anëtari jep për çdo kriter një numër të plotë pikësh brenda nivelit të zgjedhur dhe e arsyeton me një deri në dy fjali në fletën e vlerësimit.

SHTOJCA 2

KALENDARI TIP I NJË THIRRJEJE

Hapi	Afati	Përgjegjës
Urdhri dhe publikimi i thirrjes	Dita 0	Kryetari, struktura përgjegjëse
Seanca informuese dhe sqarimet	Dita 5–10	Struktura përgjegjëse
Mbyllja e aplikimeve	Dita 15 (minimumi)	Protokolli
Ngritja e Komisionit dhe deklaratat	Dita 16–17	Kryetari

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT VLORË
Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social
Sektori i Financës dhe Shërbimeve, Kordinimit të Projekteve, Politikave Sociale dhe Turizmit

Verifikimi administrativ dhe plotësimet	Dita 17–22	Komisioni
Vlerësimi teknik dhe procesverbali	Dita 22–30	Komisioni
Urdhri i miratimit dhe publikimi i listës	Dita 30–37	Kryetari
Vërejtjet dhe shqyrtimi i tyre	Dita 37–47	Kryetari, juristi
Nënshkrimi i marrëveshjeve	Dita 47–55	Kryetari, përfituesit
Zbatimi dhe monitorimi	Deri më 30 nëntor	Përfituesit, monitoruesi
Raportimi, verifikimi dhe kësti i fundit	Deri më 15 dhjetor, pagesa brenda vitit	Përfituesit, Drejtoria e Financës
Raporti vjetor në Këshill	Deri më 31 mars	Kryetari

Pika e vjetër lejonte që ndryshimet e Planit të futeshin me urdhrin e thirrjes pa ndryshuar Programin (pra Kryetari të ndryshonte përmbajtjen e një akti të Këshillit) dhe binte ndesh me nenin 31/2. Me "Planit Strategjik në fuqi" te pika 2, objektivat e rinj mbulohen pa këtë rrezik. Pika e re adreson pikën më të dobët juridike të gjithë aktit: kultura është funksion i bashkive (neni 25 i ligjit 139/2015) dhe vendimet e qarkut nuk mund të cenojnë autonominë e tyre (neni 85). "Interes publik rajonal" është formulimi juaj nga pika 3 e vendimit.
Individët aplikojnë pa NIPT. Kriteri i artit dhe kulturës vendoset një herë, për subjektet e regjistruara; për individët, përvoja provohet me dokumente (neni 16/1), sepse pikërisht mungesën e këtyre provave e ka gjetur KLSH (raporti përfundimtar 2026 për Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit) te financimet për individë. Pagesat ndaj individëve bëhen me mbajtje tatimi në burim kur e kërkon ligji (neni 23/3). Rrezik i mbetur: inspektimi financiar publik i MFE në Ministrinë e Kulturës (2024) e ka cilësuar në kundërshtim me ligjin kontraktimin e individëve të paregjistruar si përfitues projektesh. Përfshirja e shoqërive tregtare ngre edhe çështjen e ndihmës shtetërore: ose kërkoni vetëdeklarim për ndihmat e marra, ose kufizojeni thirrjen te OJF-të dhe individët.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT VLORË
Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social
Sektori i Financës dhe Shërbimeve, Kordinimit të Projekteve, Politikave Sociale dhe Turizmit

Komisioni ngrihet pas mbylljes së aplikimeve, kështu që anëtarësia në të s'mund të jetë shkak përjashtimi për aplikantin (përndryshe caktimi i një anëtari do ta skualifikonte). Rasti trajtohet nga neni 18/2: anëtari me konflikt tërhiqet dhe zëvendësohet.
Zhvendosur nga pika 6 e vendimit, që ndarja grant/prokurim të jetë në një vend të vetëm. VKM 285/2021 dhe 768/2021 ishin të sakta, por referenca te ligji dhe aktet nënligjore mjafton dhe nuk vjetrohet me ndryshimet e VKM-ve.
Mekanizmi për thirrjen e parë (neni 32): shpallje dhe vlerësim në 2026, zbatim në 2027. Thirrja vetë nuk angazhon fonde; angazhimi lind me marrëveshjen, prandaj marrëveshjet lidhen vetëm pas hyrjes në fuqi të buxhetit 2027 dhe brenda fondit të miratuar. Kushti duhet shkruar shprehimisht në urdhrin e thirrjes, që aplikantët të mos kenë pritshmëri për financim të garantuar. "Viti i zbatimit" (neni 4) zëvendëson "vitin buxhetor" te nenet 8/2, 12/1 dhe 20/5, që afatet dhe lista rezervë të llogariten për 2027.
Neni 9/1.1/d i ligjit 139/2015, që citohet në bazën ligjore, kërkon që komisionet e ngritura nga njësia të respektojnë ligjin për barazinë gjinore. Kontrolloni edhe fizibilitetin: neni 17 kërkon një jurist në Komision dhe neni 21/3 një jurist tjetër për vërejtjet.
Pika 3 financon projektet "me jo më pak se 60 pikë", kurse pika 5 fliste për "mbi 60": një projekt me saktësisht 60 pikë mbetej as i financuar, as në listën rezervë.
Fjalia e fundit e nenit 21/3 ("pas përfundimit të këtij afati") ishte e paqartë dhe afati "nga mbyllja e afatit të vërejtjeve" lejonte nënshkrimin para vendimit për vërejtjet. Tani ka një pikënisje të vetme; për thirrjen e 2026, marrëveshjet presin hyrjen në fuqi të buxhetit 2027.
Sipas nenit 83/2 të ligjit 139/2015, Kryetari i këshillit të qarkut nxjerr vetëm urdhra me karakter individual. Fjalia e shtuar i mban formularët si mjete zbatimi dhe e mbron urdhrin nga pretendimi se shton rregulla normative.

Grupi i punës:
Anisa Hyseni
Drejtor i Drejtorisë së Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social
Mauricio Pashaj
Specialist Financë për Zbatimin e Buxhetit
Ledja Kingji
Këshilltar për qeverisjen vendore, inovacionin dhe zbatimin e projekteve në Këshillin e Qarkut Vlorë